



Në bazë të nenit 12, paragrafi 2, pika (d) të Ligjit Nr-03/L-040, për vetëqeverisje lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008", të nenit 8, paragrafi 2 të Ligjit Nr-03/L-087 për ndërmarrjet publike "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-31/2008", i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-111 dhe Ligjin Nr. 05/L-009, e në mbështetje të nenit 15, lidhur me nenin 29, pika 2 të Statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, Kuvendi i Komunës së Suharekës, në mbledhjen e mbajtur më datën, ----- miratoi këtë;

Projekt-V E N D I M

Për miratimin e raportit për vitin 2021, të komisionit komunal të aksionarëve të NPL "Stacioni i Autobusëve" SH.A.

Neni 1

MIRATOHET raporti për vitin 2021 i performancës së Komisionit komunal të aksionarëve për ushtrimin e kompetencave dhe përgjegjësi në NPL "**Stacioni i autobusëve**" SH.A. me seli në Suharekë.

Neni 2

Raporti i cekur në neni 1, të këtij vendimi është shqyrtuar dhe miratuar në pajtim me dispozitat e nenit 8, paragrafi 2, të Ligjit për ndërmarrjet publike "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-31/2008", i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-111 dhe Ligjin Nr. 05/L-009.

Neni 3

Pjesë përbërëse e këtij vendim është edhe raporti me numër të protokollit 01-Nr-334-13499 i datës 03.03.2022, i përgatitur nga anëtarët e Komisionit Komunal i Aksionarëve.

Neni 4

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008" dhe nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, Nr. 10/2019, për procedurat e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunave, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 të datës 23.10.2021 dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen zyrtare të Komunës.

KUVENDI I KOMUNSËNËSUHAREKË

01-Nr-_____
Kuvendit
Me datë _____

Kryesuesi i

Mr.ec Bexhet

KUÇI



Duke u bazuar në nenin 12 paragrafi 2 pika (c) të Ligjit Nr-03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008", nenin 29 dhe 54 të Statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, të datës 04.11.2008, e në mbështetje të nenit 45 paragrafi 4, lidhur me nenin 46 paragrafi 2, të Ligjit Nr-03/L-048, për menaxhimin e financave publike të përgjithshme, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 27/2008", Kuvendi i Komunës në Suharekë, në mbledhjen e mbajtur me datën, ----- miratoi këtë;

Projekt-V E N D I M

Për miratimin e llogarisë përfundimtare të të ardhurave dhe të shpenzimeve të buxhetit të Komunës së Suharekës për periudhën **Janar-Dhjetor 2021**.

Neni 1

Me këtë vendim miratohet llogaria përfundimtare e Komunës së Suharekës për periudhën **Janar - Dhjetor të vitit 2021**, i cila përmban të dhënat si më poshtë:

Nr.Rd	Mjetet e Komunës	Realizimi 2021	Përqindja
1	Të ardhurat e gjithëmbarshme	18,064,308.44	100.00%
2	Të dalurat e gjithëmbarshme	16,922,196.86	93.68%
3	Teprica e të hyrave ndaj të dalurave	(1,142,111.58)	-6.32%
a	Teprica e të hyrave ndaj të dalurave B.R.K	210,499.91	1.17%
b	Teprica e Financimeve nga huamarrjet	31.60	0.00%
c	Teprica nga donacionet	7,766.86	0.04%
d	Teprica e të hyrave ndaj të dalurave Mjet.vetarake 2021	768,422.28	4.25%
e	Tepric e të hyrave ndaj të dalurave Mjet.vetarake 2019	155,390.93	0.86%
	Teprica për hartje në vitin 2021	923,813.21	100.00%

Neni 2

Të ardhurat dhe shpenzimet e realizuara si dhe teprica e të ardhurave në raport me shpenzimet e administruara të përcaktuara si në nenin 1 të këtij vendimi, janë shpalosur në bilancin e mjeteve të Komunës së Suharekës për periudhën **Janar-Dhjetor** të vitit 2021 dhe raporti si i tillë është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

Neni 3

Realizimi dhe zbatimi i këtij vendimi do të bëhet në pajtim me dispozita të Ligjeve në fuqi dhe Rregulloren e procedurës së përgjithshme për menaxhimin financiar të komunës së Suharekës.

Neni 4

Për zbatimin-implementimin e këtij vendimi kujdeset qeveria lokale e Komunës së Suharekës.

Neni 5

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008" dhe nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, Nr. 10/2019, për procedurat e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunave, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 të datës 23.10.2021 dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen zyrtare të Komunës.

KUVENDI I KOMUNSËNËSUHAREKË

01-Nr-_____

Kryesuesi i Kuvendit

Me datë_____

KUÇI

Mr.ec Bexhet



Në bazë të nenit 12, paragrafi 2, pika (d) të Ligjit Nr-03/L-040, për vetëqeverisje lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008", e në mbështetje të nenit 15, lidhur me nenin 29, pika 2 të Statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, e konform nenit 4 paragrafi 1, pika 1.5 lidhur me nenin 14, paragrafi 7, të Rregullores (MAPL) Nr. 01/2017 për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunës, Kuvendi i Komunës së Suharekës, në mbledhjen e mbajtur më datën, ----- miratoi këtë;

Projekt-V E N D I M

Për miratimin e Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal

Neni 1

MIRATOHET- Strategjia për Zhvillim Ekonomik Lokal për Komunën e Suharekës për periudhën 2022-2027 (në tekstin e mëtejme SZHEL).

Neni 2

Pjesë përbërëse e këtij vendim është Strategjia për Zhvillim Ekonomik Lokal për Komunën e Suharekës për periudhën 2022-2027, me numër të protokollit 01-Nr-016-26409 i datës 11.03.2022, e përgatitur nga grupi punues i formuar me vendim të Kryetarit të Komunës.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës në bashkëpunim me Drejtorët e Drejtorisë së Komunës e Suharekës.

Neni 4

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008" dhe nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, Nr. 10/2019, për procedurat e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunave, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 të datës 23.10.2021 dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen zyrtare të Komunës.

01-Nr-_____
Kuvendit
Me datë _____

KUÇI

Kryesuesi i

Mr.ec Bexhet



Në bazë të nenit 12, paragrafi 2, pika (c), nenit 17, pika (f), nenit 40 paragrafi 2, pika (a) dhe (l), të Ligjit Nr. 03/L-040, për vetëqeverisje lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008", e në mbështetje të nenit 6, të Ligjit, Nr-04/L-111, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr-03/L-087, për Ndërmarrjet Publike, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.13/2012), i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 05/L-009, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 10/2015" e konform nenit 4, lidhur me neni 5, të Rregullores Nr. 02/2013 mbi kriteret për krijimin e ndërmarrjeve publike lokale dhe pjesëmarrja e komunave në bordet e drejtorëve të ndërmarrjeve rajonale të ujit, Kuvendi i Komunës së Suharekës, në mbledhjen e mbajtur me datën, -----, miratoi këtë:

Projekt-V E N D I M

Neni 1

- 1.1** Miratohet nisma e Kryetarit të Komunës së Suharekës për themelimin e Ndërmarrjes Publike Lokale "**Eko-Theranda**" SH.A e organizuar si shoqëri aksionare, sipas Ligjit Nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare, publikuar në "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 9/2018".
- 1.2** Selia e Ndërmarrjes Publike Lokale "**Eko-Theranda**" SH.A është në rrugën "Brigada 123" në qytetin e Suharekës.

Neni 2

AUTORIZOHET, Kryetari i Komunës që të fillon procedurat ligjore për plotësimin e kushteve dhe kriterëve ashtu si që kërkohet me dispozitat e Ligjit, Nr-04/L-111, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr-03/L-087, për Ndërmarrjet Publike, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.13/2012), i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 05/L-009, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 10/2015" dhe të Rregullores Nr. 02/2013 mbi kriteret për krijimin e ndërmarrjeve publike lokale dhe pjesëmarrja e komunave në bordet e drejtorëve të ndërmarrjeve rajonale të ujit, për krijimin e Ndërmarrjeve Publike Lokale.

Neni 3

OBLIGOHET- Kryetari i Komunës që të procedoj kërkesën në Ministrin e Ekonomisë me dokumentacionin përkatës sipas dispozitave ligjore të Rregullores Nr. 02/2013 mbi kriteret për krijimin e ndërmarrjeve publike lokale dhe pjesëmarrja e komunave në bordet e drejtorëve të ndërmarrjeve rajonale të ujit, dhe pas autorizimit të mundësoj funksionalizimin e Ndërmarrjes Publike Lokale "Eko-Theranda" Sh.A. në Suharekë.

Neni 4

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, "Gazeta

zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008” dhe nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, Nr. 10/2019, për procedurat e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunave, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 të datës 23.10.2021 dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen zyrtare të Komunës.

K U V E N D I I K O M U N Ě S N Ě S U H A R E K Ě

01-Nr-_____
Kuvendit
Me datë_____

Kryesuesi i

Mr.ec Bexhet

KUÇI



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA
KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË
MUNICIPAL OF ASSEMBLY- SUHAREKË
SKUPSTINA OPSTINE SUVA REKA



Në bazë të nenit 12, paragrafi, 12.2, pika (d), lidhur me nenin 17, të Ligjit Nr. 03/L-040 për vetëqeverisje lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008", e në mbështetje të nenit 5, nënparagrafi 1.2, lidhur me nenin 11, paragrafi 1, pika 1.15 dhe neneve 15, 20 dhe 26 të Ligjit Nr.04/L-174, për planifikim hapësinor, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 30/2013", e konform me nenin 6, paragrafi 1, pika 1.5, të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.06/2018, për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna dhe neneve 15, 29, pika 2, të Statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, Kuvendi I Komunës në Suharekë, në mbledhjen e mbajtur me datë, -----, miraton këtë:

Projekt-VENDIM

Për hapjen e shqyrtimit publik të projekt-dokumentit "Harta Zonale e Komunës së Suharekës 2022-2030"

Neni 1

Lloji i dokumentit të planifikimit hapësinor

1.1 MIRATOHET Vendimi për hapjen e shqyrtimit publik të projekt-dokumentit të "Harta Zonale e Komunës së Suharekës për periudhën 2022-2030.

1.2 Projekt-dokumenti nga pika 1.1 e nenit 1, e këtij vendimi, përbëhet nga pjesa tekstuale dhe grafike, të cilat janë pjesë përbërëse të këtij vendimi.

Neni 2

Konsultimet publike

2.1 Projekt-dokumenti i cekur në nenin 1 të këtij vendimi, u lihet në dispozicion për shqyrtim publik qytetarëve, agjencive, departamenteve dhe organeve të tjera për shqyrtim dhe komente, në afat prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e parë vijuese pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

2.2 Organizimin e shqyrtimit publik të projekt-dokumentit do ta bëjë Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim në Komunën e Suharekës.

2.3 Pas përfundimit të kohëzgjatjes së shqyrtimit publik, projekt-dokumenti së bashku me një përmbledhje të shkurtër të komenteve dhe sugjerimeve të bëra gjatë diskutimit publik dhe raportin nga shqyrtimi publik po ashtu Vendimin për pëlqim të vlerësimit strategjik

mjedisor për projekt-HZK-së do t'i dorëzohen në MMPH për pëlqim të përputhshmërisë.

Neni 3

Subjekti përgjegjës

3.1 Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim në Komunën e Suharekës.

3.2 Organet tjera përkatëse kompetente do t'i kryejnë veprimet procedurale për zbatim të këtij projekt-dokumenti nga përgjegjësitë e tyre të parapara.

Neni 4

Hyrja në fuqi

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008" dhe nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, Nr. 10/2019, për procedurat e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunave, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 të datës 23.10.2021 dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen zyrtare të Komunës.

K U V E N D I I K O M U N Ë S- S U H A R E K Ë

01-Nr-_____
Kuvendit
Më datë_____

Kryesuesi i

Mr.ec Bexhet KUÇI